



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 9, Datë 05.05.2015

PËR

MIRATIMIN E PROJEKTIT FITUES TË KONKURISIT NDËRKOMBËTAR PËR  
PROJEKTIMIN URBAN TË KORRIDORIT EKONOMIK TIRANË - DURRËS


Në mbështetje të neneve 17, 27 të Ligjit nr.107/2014 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, VKM-së nr. 877, datë 03.10.2013 “Për Përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, si dhe në vijim të Vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 2, datë 08.04.2014 “Për miratimin e nismës për hartimin e Planit të Integruar Ndërsektorial për zonën ekonomike Tiranë-Durrës”, me propozimin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:


1. Miratimin e projekteve fituese të tre loteve, të Konkursit Ndërkombëtar për projektimin urban të korridorit ekonomik Tiranë – Durrës, si më poshtë:
  - a. Loti 1: “Rehabilitimi dhe Aktivizimi për Turizëm i territorit përreth Liqenit të Kasharit me; rrugica këmbësorësh/biçikletash, plazh, mobilim urban, pika me shërbime të veçanta, mol dhe trampolina”;
  - b. Loti 2: “Tre Qendra Kulturore në Vorë, Maminas dhe Bërxullë, Tre belvedere për secilën qendër banimi, Kopësht botanik në Vorë pranë qendrës së re kulturore, Urë këmbësore, Rrugë biçikletash dhe Rehabilitimi i hapësirave publike në krah dhe përgjatë segmentit të Autostratedës Tiranë – Durrës”;
  - c. Loti 3: “Hapësira Publike, Stacione Autobusi dhe Gjelbërim anësor, në 4 vende të ndryshme, përgjatë segmentit, Sukth i Ri – Durrës hyrje, në Autostradën Tiranë – Durrës”
2. Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:
  - a. Harta e planvendosjes, kufijve dhe strategjisë së zhvillimit për territoret e përfshira në Lot 1 (6 kopje).

- b. Harta e planvendosjes, kufijve dhe strategjisë së zhvillimit për territoret e përfshira në Lot 2 (6 kopje).
  - c. Harta e planvendosjes, kufijve dhe strategjisë së zhvillimit për territoret e përfshira në Lot 3 (6 kopje).
3. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Urban, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit të organizojnë dhe drejtojnë punën për zbatimin e projekteve fitues.
  4. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Urban, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Bashkia Tiranë, Bashkia Vorë, Bashkia Shijak dhe Bashkia Durrës, për zbatimin e këtij vendimi.
  5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**



**EDI RAMA**



**ZËVENDËS KRYETARE E KKT**

**EGLANTINA GJERMI**

**MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN**



**SEKRETARE E KKT**

**ADELINA GRECA**

*Adelina Greca*



**DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT**